



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1083/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik;*
 - II. Rikreditohen programet e studimit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Informatikë e Aplikuar BSc 180 ECTS; me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
 - *Inxhinieri Industriale me Informatikë BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
 - III. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit BSc 180 ECTS me specializme: 1. Menaxhment në Hoteleri, dhe 2. Menaxhment në Turizëm, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
1. Numri i studentëve si në paragrafin I, II dhe III, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
 2. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

3. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimet e bartësve bëhen me vendim nga KSHC.
4. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
5. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me bartësit e programeve si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit MSc 120 ECTS</i>	Arta Jashari Goga Fari Bushi Gazmend Deda
2.	<i>Informatikë e Aplikuar BSc 180</i>	Fakije Zejnullahu Bashkim Mustafa Bashkim Cerkini
3.	<i>Inxhinieri Industriale me Informatikë BSc</i>	Valdete Loku Gjelosh Vataj Milihate Aliu Labinot Topilla
4.	<i>Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit BSc 180 me specializimet: 1. Menaxhment në Hoteleri, dhe 2. Menaxhment në Turizëm</i>	Petrit Hasanaj Idriz Kovaçi Arbëresha Meha Muharrem Salihaj Mimoza Zhubi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit MSc 120 ECTS*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Flavio Canavero, Agnieszka Dardzinska Głębocka dhe Domagoj Svigir është organizuar më 20.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) fushë e standardeve.
2. Për programin e studimit; *Informatikë e Aplikuar BSc 180*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Flavio Canavero, Agnieszka Dardzinska Głębocka dhe Marija Vasilevska, është organizuar më 20.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) dhe Substancialisht katër (4) fusha të standardeve.
3. Për programin e studimit; *Inxhinieri Industriale me Informatikë BSc*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Flavio Canavero, Agnieszka Dardzinska Głębocka dhe Marija Vasilevska, është organizuar më 20.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht dy (2) dhe Pjesërisht tre (3) fusha të standardeve.
4. Për programin e studimit; *Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit 180 ECTS me specializimet: 1. Menaxhment në Hoteleri, dhe 2. Menaxhment në Turizëm*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Flavio Canavero, Agnieszka Dardzinska Głębocka dhe Domagoj Svigir është organizuar më 20.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) fushë të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të, të mbajtur më datë 20.05.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë